



**RREGULLORE  
PËR REGJISTRIMIN, ANËTARËSIMIN DHE  
LIÇENCIMIN NË URDHRIN E PSIKOLOGUT  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Ndryshuar me Vendim Asambleje në datë 05.07.2024**

## **Neni 1 Baza Ligjore**

Kjo Rregullore është hartuar në mbështetje të Ligjit Nr. 40/2016 “Për Urdhrit e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në legjislacionin në fuqi të shtetit shqiptar.

## **Neni 2 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është vendosja e kriterëve dhe normave për regjistrimin, anëtarësimin dhe pajisjen me Liçencën për ushtrimin individual të profesionit të psikologut.

## **Neni 3 Dispozita të Përgjithshme**

1. Urdhri i Psikologut i Republikës së Shqipërisë krijon dhe administron Regjistrin Themeltar të anëtarësisë.
2. Procesi i krijimit dhe administrimit të Regjistrit Themeltar të Psikologëve qëndron në themel të misionit dhe të veprimtarisë së Urdhrit.
3. Këshilli Kombëtar, ose personat e ngarkuar prej tij, janë strukturat që vendosin për anëtarësimin në Urdhrit e Psikologut dhe pajisjen me liçencën për ushtrimin individual të profesionit.
4. Këshillit Kombëtar është autoriteti përgjegjës për krijimin, përditësimin dhe miradministrimin e Regjistrit Themeltar.

## **Neni 4 Regjistri Themeltar i Urdhrit të Psikologut**

1. Regjistri Themeltar i Urdhrit të Psikologut është dokumenti bazë, i cili pasqyron gjendjen dhe ndryshimet sasiore dhe cilësore të psikologëve që punojnë në strukturat publike dhe private.
2. Regjistri pasqyron të dhëna lidhur me ecurinë e formimit dhe edukimit etiko-profesional e shkencor të psikologëve në vite.
3. Regjistri i psikologëve i miradministruar dhe i përditësuar rregullisht merr rol të rëndësishëm në rinovimin e Liçensës për Ushtrimin Individual të Profesionit, në varësi të kriterëve të parashikuara në këtë Rregullore.
4. Regjistri Themeltar i Urdhrit të Psikologut mbahet në formë elektronike dhe të shkruar, sipas formateve të miratuara nga kjo Rregullore. Regjistri elektronik publikohet në formë të përmbledhur në faqen zyrtare të Urdhërit të Psikologut, duke ruajtur mbrojtjen e të dhënave mekaractersensitiv të psikologut.
5. Regjistri Themeltar i Urdhrit të Psikologut duhet të përmbajë këto të dhëna:

### **TË DHËNA IDENTIFIKUESE:**

Numri i regjistrimit

Emri, Atësia, Mbiemri dhe Mbiemri i mëparshëm

Gjinia

Data e lindjes

Vendi i lindjes

Punësimi aktual

Nr. Personal i Letërnjoftimit  
Vendbanimi (adresa e banimit)  
Adresa e kontaktit (Cel., Tel., e-mail, etj.).

**TË DHËNA PROFESIONALE:**

Universiteti/Fakulteti

Data e diplomimit

Nr. i Diplomës ose i njehësimit të saj nga autoritetet kompetente për psikologët me diplomë të huaj

Gradat Shkencore/Tituajt Shkencorë

Vendi ku ka ushtruar ose ushtron profesionin si Psikolog (Institucioni shtetëror/privat; etj.)

Kohëzgjatja e punës si psikolog

**TË DHËNA ANËTARËSIE:**

Data e anëtarësimit pranë Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë

Data e pagesës së kuotave të anëtarësisë

Data e lëshimit të licencës së parë

Data e lëshimit të licencës aktualisht të vlefshme

Masa Disiplinore të dhëna ndaj psikologut

Data e rënies/shfuqizimit të masës disiplinore

Çregjistrimi nga Urdhri i Psikologut të Shqipërisë (shkaqet/arsyet dhe vendimi)

Riregjistrim

Shënime të tjera plotësuese.

## Neni 5

### Regjistri i Praktikës Profesionale

1. Regjistri i Praktikës Profesionale shërben për regjistrimin e të gjithë psikologëve të diplomuar pas hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 “Për Urdhrit të Psikologut në RSH”, që i nënshtrohen praktikës profesionale dhe, pas përfundimit të saj, provimit të shtetit.

2. Regjistri i Praktikës Profesionale mbahet në formë elektronike dhe të shkruar.

3. Për çdo psikolog që i nënshtrohet regjistrimit në praktikën profesionale hapet dosja individuale ku administrohen dokumentet si vijon:

a. Kërkesë me shkrim për anëtarësim në të cilën deklarohet detyrimi për respektimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë së Psikologut dhe Statutit të Urdhrit;

b. Vetëdeklarimi sipas formatit të përcaktuar nga Urdhri i Psikologut;

c. Fotokopje e Pasaportës ose e Letërnjoftimit;

d. Diplomat që vërtetojnë përfundimin e studimeve të larta universitare sipas ligjit. Për individët që kanë kryer studimet jashtë shtetit, dokumentin zyrtar të njehësuar nga Ministria e Arsimit.

e. Vërtetim nga profesionisti pranë të cilit psikologu i sapodiplomuar kryen praktikën profesionale

f. 3 (tre) copë fotografi 3x4 cm;

g. Tarifën e regjistrimit;

Dokumentet e mësipërme paraqiten të njehësuar me orgjinalin (të noterizuara) dhe mbeten pjesë e dosjes së praktikantit, që ruhet pranë Urdhrit të Psikologut.

4. Regjistri i Praktikës Profesionale mbahet nga Sektori i Regjistrimit/Anëtarësimit, pranë të cilit psikologët e sapodiplomuar paraqiten dhe plotësojnë dosjen e tyre.

5. Regjistri i Praktikës Profesionale përmban këto të dhëna:

**TË DHËNA IDENTIFIKUESE:**

Emri, Atësia, Mbiemri dhe Mbiemri i mëparshëm

Numri i regjistrimit

Gjinia

Data e lindjes

Vendi i lindjes

Nr. Personal ID

Vendbanimi (adresa e banimit)

Adresa e kontaktit (Cel., Tel., e-mail, etj.)

**TË DHËNA PROFESIONALE:**

Universiteti/Fakulteti

Data e diplomimit

Nr. i Diplomës ose i njehësimit të saj nga autoritetet kompetente për psikologët me diplomë të huaj

Gradat Shkencore/Titujt Shkencorë/

Profesionisti pranë të cilit ushtron Praktikën Profesionale (Institucioni shtetëror/privat; etj.)

Data e fillimit dhe mbarimit të praktikës profesionale.

Data e marrjes me sukses të “Vlerësimit për Aftësimin Praktik”.

**Neni 6**

**Regjistra të veçantë**

Urdhri i Psikologut, për nevoja të veta, mund të mbajë në Regjistra të Veçantë të dhëna shtesë që i nevojiten për çdo psikolog, si p.sh. specializime, botime ndërkombëtare të kryera, studime shkencore të kryera, etj. Regjistra të veçantë mund të mbahen edhe për kategori të ndryshme psikologësh, sipas grupimit të interesit.

**Neni 7**

**Praktika profesionale**

1. Praktika profesionale synon përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit, mënyrat e së cilës përcaktohen nga Ministria që mbulon fushën profesionale të psikologjisë, me propozimin e Urdhrit të Psikologut.
2. Praktika profesionale mund të kryhet pranë një personi fizik ose juridik, privat ose publik.
3. Urdhri i Psikologut bën regjistrimin e kandidatëve për kryerjen e praktikës profesionale dhe siguron që praktika të kryhet nën drejtimin e një profesionisti, i cili e ushtron profesionin, prej jo më pak se tre vjetësh dhe jep garanci të mjaftueshme për përgatitjen teoriko-praktike të praktikantit.
4. Në përfundim të praktikës profesionale, kandidati i nënshtrohet “Vlerësimit për aftësimin praktik” sipas ligjit.
5. Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, praktikantit i paguhen sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore nga subjekti, pranë të cilit ai kryen praktikën profesionale.
6. Përrjashtohet nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale çdo individ, i cili provon se, për një periudhë të caktuar qenë i angazhuar në një veprimtari profesionale në përputhje me kriteret specifike të profesionit të psikologut, brenda ose jashtë vendit, e që i ka dhënë mundësi të përvetësojë një përvojë profesionale të mjaftueshme në fushën e këtij profesioni.

7. Ministria, që mbulon fushën profesionale të psikologjisë, në bashkëpunim me Urdhrin e Psikologut, përcakton kriteret, që përdoren për të vlerësuar nëse përvoja profesionale e kandidatit është e mjaftueshme për ta përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale.

## **Neni 8**

### **Strukturat e ngarkuara për regjistrimin e anëtarësisë**

*(Ndryshuar me Vendimin Nr.1, datë 18.06.2021 të Asamblesë së V-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut)*

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionon Sektori i Regjistrim/Anëtarësimit dhe Komisioni i Liçencimit.
2. Sektori i Regjistrim/Anëtarësimit kryen këto funksione dhe detyra:
  - a) krijon Regjistrin Kombëtar në të cilin regjistrohen të gjithë psikologët anëtarë të Urdhrit në të gjithë vendin;
  - b) përditëson këtë regjistër, duke shtuar anëtarësimet e reja, të cilat i raportohen periodikisht Këshillit Kombëtar;
  - c) shton dhe pasqyron në kurrikulën profesionale të çdo psikologu të dhënat e reja që rezultojnë dhe raportohen nga përditësimi i regjistrave, si dhe nga burime të tjera zyrtare;
  - d) kujdeset për miradministrimin e regjistrit në faqen zyrtare të internetit dhe pasqyrimin në të me korrektësi të të dhënave dhe ndryshimeve të reja për çdo psikolog;
  - e) krijon Regjistrin e Praktikës Profesionale për psikologët e sapodiplomuar për praktikën profesionale dhe provimin e shtetit;
  - f) hap dosjet individuale për psikologët e huaj që kërkojnë të ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë, si dhe për psikologët shtetas shqiptarë që kanë kryer studimet dhe specializimet jashtë shtetit dhe anëtarësohen për herë të parë në Urdhrin e Psikologëve dhe i regjistron ata në Regjistrin Kombëtar.
3. Sektori i Regjistrim/Anëtarësimit krijohet nga administrata e Urdhrit të Psikologut dhe përbëhet nga një jurist dhe një anëtar i Zyrës së Sekretari/Arshivë/Protokollit.
4. Komisioni i Liçencimit krijohet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe përbëhet nga Presidenti i Urdhrit të Psikologut, dy anëtarë të Këshillit Kombëtar, një jurist i administratës dhe nga një anëtar i Zyrës së Sekretari/Arshivë/Protokollit. Komisioni i Liçencimit mblidhet me kërkesë të Presidentit sa herë që është e nevojshme.
5. Komisioni i Liçencimit kryen këto funksione:
  - a) bashkëpunon me Institucionet kompetente për miratimin e rregullave për liçensimin e psikologëve;
  - b) miraton zyrtarisht dhënien e Liçencës profesionale për psikologët, që kanë kryer provimin e shtetit;
  - c) verifikon plotësimin e kushteve ligjore për liçencimin e psikologëve, që përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit dhe miraton liçensimin e tyre. Përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit psikologët që, në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut”, ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e psikologut, si dhe psikologët, të cilët e fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e Këshillit të Ministrave;

d) informon Këshillin Kombëtar për të gjitha liçencimet e kryera, si dhe për rastet e refuzimit të liçencimit;

6. Çdo anëtar i Këshillit Kombëtar ka të drejtë në çdo kohë të njihet me dosjet e psikologëve të regjistruar në regjistrin e Anëtarësisë dhe të kërkojë rishqyrtimin e tyre.

## Neni 9

### Kriteret dhe dokumentacioni që nevojitet për anëtarësim

1. Anëtarët e Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë diplomën e studimeve të larta “Bachelor” dhe “Master shkencor” ose “Master profesional” në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit, dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;

ç) të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

3. Shtetasi i huaj, për ushtrimin e profesionit të psikologut në Republikën e Shqipërisë, duhet të anëtarësohet paraprakisht në Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë. Çdo psikolog, shtetas i huaj, rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht, për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatën e mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga urdhri/dhoma apo shoqata e psikologëve të vendit të vet, të njohur nga vendi ynë, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;

c) njohjen e diplomës e të certifikatave të specializimeve nga organi kompetent, të kryera prej tij/saj;

ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Psikologut;

d) dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, të vërtetuar nga një autoritet i licencuar nga shteti.

4. Personat, të cilët, në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 “Për Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, ushtrojnë profesionin e psikologut dhe kanë përfunduar dy cikle studimi në psikologji dhe, që kanë përvojë 5-vjeçare pa ndërprerje nga puna në ushtrimin e profesionit të psikologut, regjistrohen në Urdhrit të Psikologut dhe duhet të kryejnë provimin e shtetit, brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Për tu regjistruar si anëtar i Urdhrit të Psikologut duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

#### **Për shtetasit shqiptarë:**

Pasaportëose Kartë ID të vlefshme

Kërkesë për anëtarësim

Curriculum Vitae

Diploma, të cilat vërtetojnë studimet e kryera dhe titujt e fituar sipas ligjit

Nëse ka ushtruar më parë profesionin, vërtetim të protokolluar nga organi drejtues i institucionit publik apo privat, ku ka punuar

Dëshmi penaliteti

3 (tre) copë fotografi 3 x 4 cm

Dokument zyrtar, i cili vërteton se ka kaluar me sukses provimin e shtetit

Dokumentacion që provon përmbushjen e kushteve ligjore për përjashtimin nga ky detyrim, në rastet e përjashtimit për detyrimin e dhënies së provimit të shtetit.

#### **Për shtetasit e huaj:**

Leje e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

Pashaportë ose Letërnjoftim

Çertifikatë e mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga Urdhri/Dhoma apo Shoqata e Psikologëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar e ushtron profesionin dhe se nuk është i ndëshkuar dhe me masë disiplinore

Njehësimi i diplomës dhe çertifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj të lëshuara nga autoriteti shqiptar kompetent, si dhe kopje të diplomës dhe të specialitetit të njehësuar.

Rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Psikologëve.

Dokumentacioni i paraqitur nga shtetasit e huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i legalizuar, në përputhje me ligjet në fuqi.

### **Neni 10**

#### **Procedurat për anëtarësimin për herë të parë**

1. Procedurat që ndiqen janë:

a) Hapet dosja individuale e psikologut, e cila plotësohet me të gjitha dokumentet që kërkohen në rregulloret e sipërcituara.

b) Praktikantët regjistrohen në Regjistrin e Praktikës Profesionale dhe pajisen me Kartë Praktikantit, si dhe me dokumente të tjera shoqëruese për praktikën profesionale.

c) Me përfundimin e praktikës profesionale dhe kalimin me sukses të provimit të shtetit, në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore, bëhet regjistrimi përfundimtar në Regjistrin Kombëtar si anëtar i Urdhrit dhe pajisja me Kartën e Anëtarësisë dhe me Liçencën Profesionale.

### **Neni 11**

#### **Llojet e liçencave të lëshuara nga Urdhri i Psikologëve**

Urdhri i Psikologëve të Shqipërisë lëshon këto dokumenta:

1. ÇERTIFIKATË TË PRAKTIKËS PROFESIONALE TË PRAKTIKANTIT- për ushtrim të profesionit nën mbikëqyrje. Me këtë dokument pajisen psikologët e sapodiplomuar, pasi të kenë bërë regjistrimin e Praktikës Profesionale pranë Urdhrit të Psikologut. Çertifikata është e vlefshme vetëm për periudhën e kryerjes së praktikës profesionale.

2. LIÇENCË PËR USHTRIMIN INDIVIDUAL TË PROFESIONIT PËR PSIKOLOGUN - është liçenca për ushtrim të pavarur dhe i lëshohet sipas profilizimit të psikologut, i cili është i regjistruar si anëtar në Regjistrin Themeltar të Urdhrit të Psikologëve të Shqipërisë. Kjo liçencë është e vlefshme për 5 (pesë) vjet dhe me kalimin e këtij afatit rinovohet në bazë të kriterëve dhe të dokumentacionit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **Neni 12**

### **Çregjistrimi nga anëtarësia**

1. Çregjistrimi nga anëtarësia e Urdhrit të Psikologëve të Shqipërisë bëhet në rastet kur:
  - a. Psikologu paraqet një kërkesë me shkrim për çregjistrim të anëtarësisë nga Urdhri, ku paraqet shkaqet përse kërkon të çregjistrohet.
  - b. Psikologu është dënuar me vendim të formës së prerë nga organet e drejtësisë, lidhur me vepra penale, që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të psikologut.
  - c. Është marrë kjo masë nga Këshilli i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor.
  - d. Në të gjithë rastet e tjera të parashikuara nga ligjet në fuqi.
2. Në Regjistrin Themeltar të Urdhrit të Psikologëve të Shqipërisë bëhet shënimi lidhur me çregjistrimin e psikologut dhe arsyet e këtij çregjistrimi. Në asnjë rast, të dhënat e psikologut nuk fshihen nga Regjistri Themeltar.
3. Për psikologët që janë çregjistruar si anëtarë të Urdhrit të Psikologut sipas gërmës a) të paragrafit të parë, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për reregjistrim, pasi të plotësojnë edhe një herë të gjitha procedurat për regjistrimin fillestar.

### **Neni 12/1**

#### **Ndërprerja e anëtarësisë**

**(shtuar me vendim Nr. 3 datë 05.07.2024 të Asamblesë Kombëtare)**

- 1- Njoftimi i anëtareve me anë të e-mailit për rikujtimin e shlyerjes së kuotizacionit vjetor.
- 2- Ndërprerja e anëtarësisë bëhet me vendim të Komisionit të Regjistrim/Anëtarësim të Urdhrit të Psikologut.
- 3- Vendimi për ndërprerjen e anëtarësisë i komunikohet brenda 5 ditëve anëtarit dhe institucionit ku ai ushtron profesionin si psikolog.
- 4- Kundër këtij vendimi psikologu ka të drejtën e ankimit në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Psikologut brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.

### **Neni 13**

#### **Ankimi**

Ndaj çdo vendimi të dhënë ndaj psikologut lidhur me mosregjistrimin, mosliçencimin apo mosrinovimin e liçencës, psikologut i lind e drejta që brenda 15 ditësh të paraqesë ankesë pranë Këshillit Kombëtar.



**Neni 14**  
**Dispozita të fundit**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

---

**Miratuar me vendimin nr.1, datë 30.06.2017 të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.**